



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Vlerësimit Institucional të  
Universitetit Bujqësor të Tiranës**

**Nëntor 2021**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- |                              |         |
|------------------------------|---------|
| 1. Elvin Gjevori, PhD        | Kryetar |
| 2. Prof.As. Florim Grajcevci | Anëtar  |
| 3. Prof. As. Lul Raka        | Anëtar  |

## Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	4
Konteksti i këtij vlerësimi .....	5
Raport i përmbledhur .....	6
Përmbledhje e gjetjeve.....	8
Praktika e mirë.....	8
Pikat e dobëta .....	8
Rekomandimet .....	8
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	9
Përmbledhje e gjytimeve për çdo Fushë Vlerësimi.....	10
Gjykim i përmbledhur .....	11
Raport i detajuar .....	12
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij .....	12
Gjetjet .....	17
Praktika e mirë.....	17
Pikat e dobëta .....	17
Rekomandimet .....	17
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	18
Gjykimi .....	18
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet .....	19
Gjetjet .....	24
Praktika e mirë.....	24
Pikat e dobëta .....	24
Rekomandimet .....	24
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	24
Gjykimi .....	24
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula .....	25
Gjetjet .....	28
Praktika e mirë.....	28
Pikat e dobëta .....	28
Rekomandimet .....	28
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	28
Gjykimi .....	28
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi.....	29
Gjetjet .....	33
Praktika e mirë.....	33
Pikat e dobëta .....	33
Rekomandimet .....	33
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	33
Gjykimi .....	33
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	34
Gjetjet .....	37
Praktika e mirë.....	37
Pikat e dobëta .....	37
Rekomandimet .....	37
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	37
Gjykimi .....	37
Lista A: Lista e evidencave:.....	38
Lista B: Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës.....	47
Lista C: Lista e evidencave të mundësuar gjatë vizitës .....	47

## **Rreth këtij vlerësimi**

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i vlerësimit të jashtëm, që përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të caktuar nga ASCAL.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por do të përdoren edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut të gjerë dhe organeve studentore informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu vetë IAL-të të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxëniet e studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fushat e Vlerësimit: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që vlerësuesit mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, rishikuesit e përmbyllin procesin duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Bordin e Akreditimit të ASCAL-IT. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

## Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) kremton përvjetorin e 70-të të themelimit në vitin 2021, duke qenë universiteti më i vjetër në Shqipëri, çka përbën krenari për pedagogët dhe nivelin drejtues të universitetit. I themeluar në vitin 1951 si institut bujqësor, në vitin 1991, UBT-ja mori statusin e plotë të universitetit dhe, që prej atëherë, është zgjeruar dhe zhvilluar përtej rolit fillestar të kufizuar, që konsistonte vetëm në formimin e ekspertëve për bujqësinë moderne shqiptare në proces zhvillimi.

Universiteti përbëhet nga pesë fakultete: **(1)** Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) me 6 departamente, **(2)** Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) me 6 departamente, **(3)** Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU) me 3 departamente, **(4)** Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) me 3 departamente, **(5)** Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (FMV) me 4 departamente dhe **(6)** Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve. Të gjitha fakultetet, me përjashtim të Institutit, ofrojnë programe studimi të strukturuar në të 3 ciklet e studimeve dhe janë përfshirë në veprimtari të gjera kërkimore.

Me zgjerimin progresiv, universiteti ka zhvilluar një rrjet të gjerë marrëveshjesh bashkëpunimi ndërkombëtar dhe, aktualisht, përmes mbështetjes dhe drejtimit të qeverisë shqiptare, universiteti është duke finalizuar një partneritet të ngushtë institucional me Universitetin e Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës të Vjenës në Austri. Sipas grupit të vlerësimit të jashtëm, marrëveshja do të përfshinte shumicën e aspekteve të jetës universitare dhe shërbente si një katalizator i rëndësishëm i ndryshimeve institucionale, kulturore dhe akademike në universitet. Pavarësisht kësaj, duke qenë se kjo marrëveshje nuk ishte finalizuar ende dhe nuk ishte përfshirë në raportin e vlerësimit të brendshëm, grupi i vlerësimit nuk mund të mbajë qëndrim lidhur me të.

## Raport i përmbledhur

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është institucioni publik më i vjetër i arsimit të lartë në Shqipëri dhe fitoi statusin e plotë të universitetit në vitin 1991. Duke qenë universiteti më i vjetër dhe i vetmi kushtuar bujqësisë, ai është një institucion unik në Shqipëri dhe ka një pozicion të mirëpërcaktuar në sfondin e arsimit të lartë shqiptar. Universiteti është i organizuar në 5 fakultete dhe 1 institut, që ofrojnë programe studimi në të tre ciklet e studimit. Sikurse parashikon ligji, Universiteti është një person juridik publik me qendër në Kodër Kamëz jashtë Tiranës, dhe është i vetmi institucion i arsimit të lartë me sistem kampusi plotësisht të përqendruar.

Universiteti ofron 62 programe studimi në ciklin 1 dhe 2 të studimeve në të gjitha fakultetet e tij, si dhe përdor Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Ai ofron 21 programe studimi të ciklit të parë të studimeve dhe 41 programe të ciklit të dytë të studimeve. Për vitin akademik 2020 - 2021, universiteti regjistroi 1178 studentë të rinj në ciklin e parë, 927 në ciklin e dytë dhe 25 në ciklin e tretë. Sikurse kërkohet me ligj, universiteti ka aplikuar për riorganizimin e programeve të doktoraturës dhe grupi i vlerësimit të jashtëm u informua se pret miratim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) për të nisur me regjistrimin e studentëve të rinj të doktoraturës. Gjithashtu, universiteti ka aktivizuar programin e parë ekzekutiv për master në Shqipëri, që është në proces akreditimi nga një agjenci akreditimi anëtare e ENQA-së.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional për universitetin, për të vlerësuar se deri në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që janë miratuar fillimisht në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë institucional të kryer në dhjetor të vitit 2016 identifikoi **16** tipare të praktikës së mirë, **4** pika të dobëta, dha **4** rekomandime të cilat universiteti duhet t'i trajtojë, dhe pohoi **5** veprime në progres e sipër.

Në raportin e fundit (2016) të vlerësimit të jashtëm institucional u shënuan gjykimet e mëposhtme për secilën fushë vlerësimi:

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur plotësisht.**

Në dhjetor të vitit 2016, vlerësuesit i rekomanduan Bordit të Akreditimit se Universiteti Bujqësor i Tiranës i kishte **përmbushur kryesisht** standardet shtetërore të cilësisë dhe, për rrjedhojë, Universitetit i ishte dhënë akreditimi nga Bordi për një periudhë **katërvjeçare**.

Bazuar në Manualin për Procedurat të Agjencisë shqiptare të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), UBT-ja filloi procesin e vetëvlerësimit për t'u përgatitur për vlerësimin e akreditimit periodik institucional, që u drejtua nga një grup pune i vetëvlerësimit të brendshëm, i përbërë nga gjashtë anëtarë stafi me njohuri të gjera rreth universitetit dhe një përfaqësues i studentëve. Grupi i punës u ngrit nga Senati Akademik dhe iu vunë në dispozicion dokumentet, statutet dhe rregulloret e brendshme të universitetit, së bashku me të gjitha të dhënat statistikore dhe raportet përkatëse. Grupit iu desh të shqyrtonte edhe rekomandimet e Bordit të Akreditimit të dhëna pas vlerësimit të vitit 2016. Përpara se të finalizoheshin, projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në universitet. Senati Akademik autorizoi publikimin e raportit përfundimtar dhe dorëzimin e tij zyrtar tek ASCAL.

Vlerësimi u krye gjatë dy ditëve, në datat **30 shtator dhe 1 tetor të vitit 2021**. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga tre vlerësues, njëri prej të cilëve ishte nga Shqipëria (kryetari) dhe 2 nga Kosova. Grupi i vlerësimit të jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit i mundësuar nga ASCAL-i. Grupi i vlerësimit të jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe të gjitha evidencat mbështetëse përpara vizitës së vlerësimit, që më pas u plotësuan me dokumentacion shtesë të kërkuar përpara dhe gjatë vizitës.

Informacioni mbështetës i ofruar nga UBT-ja i dha mundësinë grupit të njëjti me strukturën, politikat dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Evidencat përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembuj rreth informacionit të programit dhe evidenca numerike nga produktet kërkimore.

Gjatë vizitës së vlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, me alumnit si dhe partnerë të jashtëm. Vizita dhe diskutimi ndihmuan me sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e vizitës, u zhvillua një orientim rreth të nxëniet, mësimdhënies dhe burimeve kërkimore në kampusin e universitetit, në ambientet e kërkuara nga grupi i vlerësimit të jashtëm.

Anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mund të konfirmojnë sa më poshtë lidhur me pikat e dobëta dhe rekomandimet përkatëse të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm të vitit 2016:

- I) Për sa i përket rekomandimit se universiteti duhet të krijojë përshkrime pune për secilin funksion, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se është përmbushur, pasi kontratat për secilin pozicion përcaktojnë kërkesat dhe pritshmëritë përkatëse;
- II) Për sa i përket rekomandimit se universiteti duhet të trajtojë çështjen e cilësisë së laboratorëve të mësimdhënies, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se ka pasur një ecuri të konsiderueshme dhe të ndjeshme, ku përfshihen një sërë investimesh të kryera, disa ende në proces, ndërsa të tjera të planifikuara për vitin akademik 2021-2022, si dhe akreditimi ndërkombëtar i disa prej laboratorëve. Megjithatë, duke pasur parasysh ritmin e shpejtë të zhvillimit shkencor, dhe nivelin e ulët të modernizimit në filluesën e universitetit, kjo çështje duhet të vijojë të jetë në qendër të vëmendjes së nivelit drejtues të universitetit;
- III) Për sa i përket rekomandimit se universiteti duhet të hetojë problematikat e vlerësimit të ngritura nga anketa e studentëve, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se është përmbushur, pasi universiteti zhvillon anketa të strukturuar dhe periodike të studentëve, që, sikurse raportohet nga studentët dhe personeli, janë marrë në konsideratë për rishikimin periodik të programeve akademike dhe ngritjen në kategori të personelit;
- IV) Për sa i përket rekomandimit se universiteti duhet të rrisë nivelin kërkimor, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se ka pasur ecuri të konsiderueshme dhe të ndjeshme, pasi një numër jo i vogël stafi publikojnë punime në revista të njohura ndërkombëtarisht dhe marrin pjesë në projekte me financim ndërkombëtar. Në këtë drejtim, UBT-ja paraqitet në vendin e parë të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë. Megjithatë, duke qenë se universiteti duket se po shkon drejt një rruge të re dhe ambicioze ndërkombëtarizimi, më tepër energji, financim dhe mbështetje e strukturuar nevojiten në këtë fushë, në mënyrë që të konsolidohen më tej rezultatet e arritura dhe ecuria.

## **Përmbledhje e gjetjeve**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Zbatimi i projektit STEPS është një praktikë e mirë, që duhet të përdoret dhe zgjerohet si një model për thithjen e fondeve ndërkombëtare, mundësimin e bashkëpunimit rajonal dhe përfshirjen e palëve të interesit përkatëse në zhvillimin e programeve të studimit me bazë shkencore dhe të përshtatshme për tregun. **[Kapitulli III, Standardi III.2].**
- Marrëveshjet e strukturuar me bashkitë janë një praktikë e mirë për mundësimin e zbatimit të përshtatshëm të praktikave të mësimdhënies dhe hapjes së universitetit për të gjithë aktorët e jashtëm të përfshirë në zbatimin e dijeve të prodhuara nga universiteti lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. **[Kapitulli III, Standardi III.3].**
- Përfshirja aktive e stafit akademik në partneritete ndërkombëtare dhe projekte kërkimore. **[Kapitulli II, Standardi I.3].**

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Rezultatet e vlerësimit të studentëve identifikuan një sërë mangësish institucionale serioze që, me aq sa GVJ-ja arriti të konstatonte, nuk ishin ndjekur dhe trajtuar. **[Kapitulli I, Standardi II.3].**

### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UBT-ja duhet të trajtojë rezultatet e vlerësimit të studentëve në mënyrë të strukturuar dhe institucionale, dhe të marrë masat e duhura për rastet e konfirmuara të abuzimit **[Kapitulli I, Standardi II.3].**
- UBT-ja duhet të marrë masa proaktive për të rritur ndjeshëm numrat e mobilitetit ndërkombëtar, veçanërisht për studentët si dhe personelin; **[Kapitulli III, Standardi III.4].**
- UBT-ja duhet të rrisë përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore dhe të fuqizojë sistemin për zbulimin e plagjiaturës përmes workshop-eve dhe seminareve për studentët **[Kapitulli I, Standardi II.2].**
- UBT-ja duhet të rrisë buxhetin për kërkimet dhe të përgatisë një plan të qartë veprimi për zbatimin e strategjisë së kërkimit, duke përcaktuar synimet kyçe,



treguesit e performancës dhe afatet kohore për veprimet **[Kapitulli II, Standardi I.4].**

- UBT-ja duhet të rishikojë dhe përditësojë dokumentet e veta strategjike kryesore (plani strategjik i zhvillimit dhe strategjia e kërkimit) për të pasqyruar si vizionin strategjik të Rektorit, po ashtu dhe zhvillimet e vazhdueshme lidhur me bashkëpunimin e strukturuar me Universitetin e Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës së Vjenës, Austri; **[Kapitulli III, Standardi I.5].**
- Konceptualizimi tejet i ngushtë dhe deri diku mekanik i 'angazhimit të alumnit' ka ndikuar aftësinë e universitetit për të organizuar mjedisin e jashtëm në të cilin operon, çka ka cenuar suksesin e disa prej programeve të studimit më të konsoliduara dhe të vjetra të universitetit. Prandaj, UBT-ja duhet të hartojë një strategji/plan veprimi të qartë për angazhimin dhe shfrytëzimin e alumnit të vet për të organizuar mjedisin e jashtëm në të cilin operon, si mënyrë, ndër të tjera, për të përmirësuar situatën e disa prej programeve të studimit në vështirësi (sikurse tregohet nga numri i ulët i studentëve të regjistruar); **[Kapitulli III, Standardi III.2].**
- UBT-ja duhet të pasurojë, institucionalizojë dhe profesionalizojë marrëdhënien me aktorët e tregut të punës dhe studimet e tregut duhet të përfshijnë palë interesi të jashtme dhe të pavarura. Të gjitha departamentet e UBT-së duhet të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre me palët e jashtme të interesit për të siguruar përputhshmërinë e shërbimeve dhe programeve përkatëse të studimit me nevojat e tregut shqiptar të punës në zhvillim e sipër dhe zhvillimin e përgjithshëm. **[Kapitulli III, Standardi III.1].**
- UBT-ja duhet të krijojë një mekanizëm/instrument monitorimi dhe përditësimi periodik për faqen institucionale të internetit dhe të gjitha faqet e internetit të fakulteteve, për të siguruar se informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, aktual dhe i saktë. **[Kapitulli III, Standardi VII.1].**
- UBT-ja duhet të Pasurojë përmbajtjen e faqes së internetit të institucionit në gjuhën angleze **[Kapitulli I, Standardi III.2].**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- UBT-ja po finalizon një riorganizim administrativ, bazuar në statutin e rishikuar, çka paraqet një mundësi ideale për trajtimin e pikave të dobëta të identifikuara nga grupi i vlerësimit të jashtëm dhe për përfshirjen e rekomandimeve të tyre në të gjitha proceset e universitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.1].**
- UBT-ja po kalon nëpër një proces ndërkombëtarizimi të shpejtë dhe të strukturuar, sikurse pasqyrohet në marrëveshjen me Universitetin e Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës së Vjenës, Austri. Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet për të trajtuar disa nga gjetjet e grupit të vlerësimit të jashtëm për sa i përket mobilitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

- UBT-ja tregon vëmendje dhe kujdes për të siguruar se godinat (e vjetra), që nuk ofrojnë akses të pakufizuar për personat me aftësi të kufizuara, do të përshtaten në përputhshmëri të plotë me kërkesat përkatëse. **[Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1]**
- Ndërtimi i godinave të reja nga UBT-ja do të ndihmojë me përmirësimin e infrastrukturës institucionale në dispozicion të veprimtarive mësimore dhe kërkimore.

### **Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi**

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht;**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht;**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht;**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht;**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

## **Gjykim i përmbledhur**

**Vlerësuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë në Universitetin Bujqësor të Tiranës janë përmbushur plotësisht.**

## Raport i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Përgjatë RVV-së dhe gjatë vizitës në ambient, universiteti ka paraqitur prova të konsiderueshme lidhur me ekzistencën e mekanizmave institucionale të mirëpërcaktuara të posaçme për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm **[A.1.1 deri tek A. 1.11]**. Konkretisht, grupi i vlerësimit të jashtëm mund të nënvizojë disa nga më të posaçmet në perspektivë ligjore/strukturore: Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) respekton dispozitat themelore të Ligjit nr. 80/2015 të datës 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe funksionon si një institucion publik i arsimit të lartë, sikurse përcaktohet në statutin përkatës **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 1 dhe 2, miratuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit më 28.07.2021]**. Organet kolegjinale të menaxhimit të UBT-së janë: Senati Akademik **[A.1.26]**, Bordi i Administrimit **[A.1.27]**, asambleja e stafit akademik dhe komisionet e përhershme. Organet e tjera kolegjinale të menaxhimit të universitetit janë Rektorati, Këshilli i Etikës dhe këshillat e fakulteteve **[A.1.42 Statuti i UBT-së, seksioni 3, pika 1 dhe 2]**. Autoritetet ekzekutive të universitetit përfshijnë Rektorin, Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve **[A.1.42 Statuti i UBT-së, nenet 5, 6 dhe 9]**. Rregullorja e UBT-së për Studimet Universitare përcakton me detaje dhe qartë organizimin dhe proceset e vendimmarrjes së universitetit për sa i përket tërësisë së procesit akademik **[A.1.43 Rregullorja e Studimeve Universitare, Kapitulli 2]**. Gjithashtu, krahas dokumenteve që zbatohen në mbarë institucionin, UBT-ja ka edhe rregullore të brendshme funksionimi dhe strategji kërkimore në nivel fakulteti **[A.1.44 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit]**. Bazuar në statut, dhe duke reflektuar rregulloren e studimeve universitare, UBT-ja ka hartuar dhe përditësuar një grafik organizativ të qartë dhe të qëndrueshëm, në të cilin përcaktohen të gjitha marrëdhëniet hierarkike në universitet **[A.1.29 Grafiku Organizativ i UBT-së]**. Në mënyrë disi të habitshme, statuti i ri përfshin një institut kërkimi shkencor **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 7]**, që nuk pasqyrohet në grafikun organizativ. Rektori na bëri me dije se instituti nuk është funksional dhe sapo të bëhet i tillë do të përfshihet në grafik **[BM2 Mbledhja me Rektorin]**. Megjithatë, me sa kuptojmë, duke qenë se kjo njësi kryesore është përfshirë në statut, duhet të përfshihet në një mënyrë edhe në grafikun organizativ. Gjithashtu, të gjitha njësitë akademike të UBT-së, fakultetet dhe departamentet, gëzojnë dhe ushtrojnë liri akademike **[A.1.3 deri te 1.7]**, që ushtrohet kryesisht përmes zgjedhjes periodike dhe të hapur të dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve dhe në periudhën ndërmjet zgjedhjeve nga asambletë e fakulteteve, që rezultojnë nga zgjedhjet në fjalë **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 2 pika 4, 5 dhe 6]**. **[Kapitulli III, Standardi I.1]**.
- 1.2 Vendimet kryesore që prekin jetën akademike në nivel fakulteti dhe departamenti, si hartimi dhe rishikimi i programeve dhe kurrikulave të studimit, shpërndarja e burimeve të posaçme për mësimdhënien dhe, deri në një farë mase, ato të posaçme për kërkimin, prioritetet dhe drejtimet kërkimore, planet mësimore dhe bashkëpunimi me palët e treta (ndërkombëtare) e kanë filluesën dhe strukturohen në nivel departamenti dhe fakulteti **[A.1.43 Rregullorja e Studimeve Universitare, Kapitulli 2]**. Sikurse në vizitën e fundit vlerësuese, universiteti sapo ka ndryshuar sërish statutin, që është në proces zbatimi të plotë. Megjithëse grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me statutin e miratuar **në ditën e vizitës**, u habitëm kur mësuam se niveli i lartë drejtues i universitetit nuk kishte dijeni se statuti ishte miratuar nga ministria përkatëse **[BM10 Mbledhja me drejtuesit e lartë të universitetit]**. Statuti i ri riorganizoi disa nga zyrat e rëndësishme, si atë të burimeve njerëzore, kërkimit, si dhe shtoi një zëvendësrektor të tretë **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 16 dhe 18/1]**. Megjithatë, as stafi mbështetës nuk ishte në dijeni se statuti i ri ishte miratuar në korrik të vitit 2021. **[BM9 Mbledhja me stafin mbështetës]**. Ky është një tregues se procesi i vlerësimit mund të mos ketë qenë mjaftueshëm përfshirës, të paktën

në fazat përfundimtare. Ajo çka është me rëndësi është se meqë ndryshimet tashmë janë miratuar, zbatimi i tyre duhet të jetë përfshirës dhe transparent për të siguruar qëndrueshmërinë e organizimit të ri dhe jetëgjatësinë e tij. **[Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.4].**

- 1.3 Për sa i përket menaxhimit financiar, ai sigurohet kryesisht nga Bordi i Administrimit, që është i pavarur nga rektori i UBT-së **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 15]**. Pavarësisht kësaj, dhe më e rëndësishmja, buxheti i universitetit është projektuar në mënyrë nga poshtë lart duke filluar në nivelin e departamentit **[A.2.54]**. Departamenti kryen identifikimin e nevojave, si dhe planifikon veprimtaritë kryesore, që miratohen në nivel fakulteti, më pas në nivel rektorati, duke përfunduar në nivel senati **[BM10 Mbledhja me drejtuesit e lartë të universitetit]**. Gjatë takimeve që kemi zhvilluar, u informuam se procesi është eficient dhe joproblematik, duke qenë se fakultetet kanë nevoja specifike dhe të identifikueshme që nuk bien ndesh me njëra-tjetrën **[BM6 Mbledhja me grupin përfaqësues të stafit mësimdhënës]**. Krahas kësaj, meqenëse të gjithë aktorët ishin në dijeni të kufizimeve të përgjithshme financiare, ishin mësuar të 'prisnin radhën' dhe të akomodonin nevojat e njëri-tjetrit në një mjedis me burime financiare të fundme. Gjithsesi, sikurse iu tha grupit të vlerësimit të jashtëm nga ana e rektorit, institucioni është i vetëdijshëm se universiteti mbështetet në mënyrë disproporcionale të buxheti i shtetit dhe tarifave studentore për funksionet përkatëse. Rektori na bëri me dije se ai ka planifikuar t'i transformojë disa nga asetet e universitetit në subjekte fitimprurëse përmes institucionalizimit të aftësisë së universitetit për të drejtuar shoqëri tregtare **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 12]**. Bordi i Administrimit mbikëqyr të gjitha funksionet ekonomike dhe administrative të UBT-së, që janë rreptësisht të veçuara nga drejtimi akademik i universitetit **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 14]**. Megjithëse në shumë universitete të tjera publike kjo formë organizimi ka shkaktuar konflikte të shpeshta, në UBT nuk ka ndodhur, ndaj meriton të vlerësohet për aftësinë për t'u përshtatur me kërkesat ligjore dhe që e ka arritur këtë në një frymë bashkëpunimi. Po ashtu, si pjesë e ndryshimeve të ndërmarra së fundmi, Këshilli i Etikës është fuqizuar më tej pasi është përcaktuar si organi më i rëndësishëm kolegjal pas senatit akademik **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 17]** dhe ka grupin e vet të rregulloreve që drejtojnë sjelljen etike të stafit. **[A 1.84 Rregullorja e Etikës e UBT-së]**. Gjithashtu, sikurse kërkohet me ligj, UBT-ja ka ngritur komisionet e përhershme për i) sigurimin e cilësisë dhe kërkimin shkencor dhe ii) ngritjen në kategori të personelit akademik **[A. 1.42 Statuti i UBT-së, neni 18/1]**. Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve zgjidhen për një mandat katërvjeçar, sikurse parashikon ligji. Studentët, stafi akademik dhe jo akademik mund të marrin pjesë në zgjedhjet për autoritetet drejtuese të universitetit. Po ashtu, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik **[A.1.42 Statuti i UBT-së, neni 14, pika 4]**. Zgjedhjet për postet e larta janë të drejta dhe transparente, në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit **[Kapitulli III, Standardi I.2]**.
- 1.4 Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe mbledhjet e mbajtura në institucion, u konstatua se ekzistonte një frymë relativisht e hapur diskutimi konstruktiv në UBT. Senati Akademik, Asambletë e Fakulteteve dhe departamentet janë mbledhur periodikisht për të diskutuar dhe marrë vendime në bazë të një agjende të miratuar paraprakisht **[RVV, f. 21]**. Nuk arritëm të gjenim raste mosmarrëveshjesh domethënëse në këto organe kolegjinale. Për të ndihmuar me monitorimin efikas të shërbimeve në UBT ekzistojnë një sërë organesh ndërmjetëse, shumica prej të cilave janë riorganizuar sipas statutit të ri. Konkretisht, është shtuar një zëvendësrektor i ri për të zgjeruar ndërkombëtarizimin e universitetit dhe partneritetet me palët e treta, dhe zyra e burimeve njerëzore dhe zyra e kërkimit akademik janë riorganizuar në drejtori **[RVV, f. 35]**. Duke qenë se këto janë zhvillime të reja, mbetet për t'u parë se sa efektive do të jenë. Në këtë drejtim, Senati Akademik duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë këtij organizimi dhe të kërkojë raportim periodik nga zyrat e reja. Në përgjithësi, grupi i vlerësimit të jashtëm konfirmon se universiteti ka në funksion organe/instrumente kolegjinale dhe ekzekutive, që i bëjnë të mundur të monitorojë efektshmërinë e vet brenda kuadrit të kufijve autonomë **[Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3]**.

- 1.5 Rektorati, nën drejtimin e rektorit, ka përgjegjësi hartimin e planit strategjik të zhvillimit të universitetit. Plani strategjik ekzistues për vitin 2016-2025 përcakton objektivat dhe mënyrat për arritjen e rezultateve të prishme sipas misionit dhe qëllimit të UBT-së dhe në përputhje me prioritetet kombëtare **[A.1.1 Strategjia e Zhvillimit e UBT-së]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se, megjithëse Plani Strategjik i UBT-së përfshin një vizion strategjik, strategji kërkimi, zhvillimin e studentëve dhe stafit, dhe sigurimin e cilësisë, ndër të tjera, zhvillimet aktuale dhe vizioni strategjik i Rektorit të ri për universitetin nuk janë pasqyruar plotësisht në këtë dokument. Veçanërisht, partneriteti i ri strategjik me Universitetin e Shkencave të Jetës në Vjenë, Austri, dhe efektet përkatëse pasuese duhet të analizohen në nivel makro dhe të pasqyrohen në planin strategjik të zhvillimit të UBT-së. Kjo është e rëndësishme për të siguruar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e ndryshimeve madhore në proces. Po e njëjta mund të thuhet për strategjinë e kërkimit të UBT-së **[A.1.2 Strategjia e UBT-së për Kërkimin Shkencor, Kapitulli III, Standardi I.5]**. Të dyja këto dokumente janë hartuar mbi pesë vite më parë dhe aktualisht nuk pasqyrojnë zhvillimet në UBT apo drejtimin që duket se po ndjek. **Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, veçanërisht duke u bazuar në mbledhjet me rektorin dhe drejtuesit e lartë të universitetit, sugjeron fuqimisht se këto strategji duhet të rishikohen për të përfshirë, institucionalizuar dhe siguruar mbështetje të përshtatshme për zhvillimet aktuale në institucion. [Kapitulli III, Standardi I.5]**
- 1.6 Sikurse parashikohet me ligj, UBT-ja i dërgon një raport vjetor ministrisë përgjegjëse për arsimin në Shqipëri. Raporti hartohet, krijohet dhe rishikohet nga një sërë punonjësish të nivelit të lartë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti, që vlerëson procesin e mësimdhënies, ofron një analizë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të procesit dhe debatohet në mbarë institucionin **[Kapitulli III, Standardi I.6]**.
- 1.7 Sikurse mund të shihet në skemën organizative **[A 1.28]**, universiteti përfshin pesë fakultete: Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Fakultetin e Shkencave Pyjore, Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Secili nga këto fakultete ka të paktën tre departamente, në përputhje me Statutin e UBT-së dhe Ligjin për Arsimin e Lartë. Këto fakultete ofrojnë programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë **[Kapitulli III, Standardi II.1]**.
- 1.8 UBT-ja deklaron se është përfshirë plotësisht në dinamikën e biznesit dhe se e përdor këtë informacion për të monitoruar përshtatshmërinë e kurrikulave të veta dhe hapjen e programeve të reja të studimit. **[BM2 Mbledhja me rektorin; BM10 Mbledhja me drejtuesit e lartë të universitetit; RVV]**. Megjithëse, siç kërkohet me ligj, universiteti zhvillon studime periodike të tregut, këto studime kryhen në institucion nga stafi i departamentit që 'mban' programin e studimit **[BM6 Mbledhja me grupin përfaqësues të stafit mësimdhënës]**. Grupi i vlerësimit të jashtëm sheh një konflikt të mundshëm interesit në këtë drejtim, pasi stafi akademik ka interes për vazhdimësinë e programit të studimit në të cilin zhvillojnë mësim. **Prandaj, në mënyrë që të pasurohet, institucionalizohet dhe profesionalizohet marrëdhënia me tregun e punës, studimet e tregut të punës duhet të përfshijnë palë interesit të jashtme dhe të pavarura. Të gjitha departamentet duhet të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre me palët e jashtme të interesit për të siguruar përputhshmërinë e shërbimeve përkatëse me nevojat e tregut shqiptar të punës në zhvillim e sipër. [Kapitulli III, Standardi III.1].**
- 1.9 Duke qenë se UBT-ja është një universitet që punon me shkencat e aplikuara të jetës, marrëdhënia me partnerët e jashtëm është thelbësore, si për praktikën e mësimdhënies, po ashtu edhe për pozicionet afatgjata të punës. Nga të gjitha mbledhjet tona me larminë e palëve të interesit në universitet, ku kryesorët ishin vetë studentët, mësuam rreth rëndësisë së këtyre praktikave **[BM11 Mbledhja me partnerët e jashtëm dhe alumni; BM3 Mbledhja me grupin përfaqësues të studentëve të ciklit të parë; BM4 Mbledhja me grupin përfaqësues të studentëve të ciklit të dytë]**. Dy vitet e fundit janë bërë edhe më të ndërlikuar për shkak të kufizimeve nga COVID-19, çka ua ka

vështirësuar vlerësuesve të kryejnë një vlerësim koherent të efektshmërisë së praktikave mësimore të universitetit dhe pozicioneve të punës. Pavarësisht kësaj, në tërësi, partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit konfirmuan se studentët e caktuar në pozicione pune dhe ata që arrijnë të punësohen zotërojnë njohuri të mira teorike dhe janë të aftë të bëhen profesionistë të suksesshëm. Pavarësisht kësaj, ka pasur raste, sikurse raportohet nga një përfaqësues i një partneri të jashtëm dhe një student **[BM11 dhe BM4]**, ku përgatitja e studentëve duhet të ishte më e mirë për t'iu bërë të mundur të integroheshin më lehtësisht në kushtet profesionale të tregut të punës.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se, për sa i përket Qendrës së Karrierës dhe Alumni, ka pasur ecuri të konsiderueshme që nga vlerësimi i jashtëm i fundit. Megjithatë, vumë re se 'të kuptuarit/konceptualizimi i alumnit' ishte shumë i kufizuar dhe nuk e ndihmonte universitetin të zgjidhte një sërë problematikash të rëndësishme të identifikuar drejtë nga stafi akademik. Në mbledhjet me drejtuesit e lartë, stafin akademik dhe partnerët e jashtëm **[BM 6, BM10 dhe BM11]**, u informuam se njëra nga arsyet se përse disa nga programet, si pylltaria për shembull, ishin në vështirësi ishte pasi autoritetet vendore, në kundërshtim me ligjin, nuk punësonin inxhinierë pylltarie, çka i dekurajonte studentët të studionin në këtë program. Megjithëse kjo problematikë paraqet një 'situatë ideale' që universiteti të organizojë alumnit e vet si një grup interesi për të ushtruar presion për ndryshim, çka është në të mirë të universitetit, këto veprimtari dhe praktika nuk ishin kryer. Sipas këndvështrimit të vlerësuesve, kjo do të thotë se përmbushja e *Standardit III.1* duhet të konsiderohet më pak si një kërkesë formale për të pasur një post, staf të posaçëm dhe veprimtari të rastësishme, por të shihet si një sërë angazhimesh të strukturuar me 'botën e jashtme' përmes ish-studentëve dhe stafit, për të organizuar hapësirën në të cilën universiteti operon, në favor të universitetit dhe, më e rëndësishmja, të studentëve të vet. **Kjo gjë kërkon një rikonceptualizim të shtrirjes së alumni dhe angazhimit të tyre jashtë kufijve formalë minimalë të parashikuar në standardet shqiptare të cilësisë.**

Sikurse është konstatuar në vlerësimin e mëparshëm, kur bëhet fjalë për bashkëpunimin rajonal, i është dhënë një farë prioriteti bashkëpunimit me zonat shqipfolëse të Ballkanit Perëndimor. Kjo duket si një qasje e arsyeshme, që mund të sjellë përfitim të përbashkët për të gjitha palët e përfshira. Në ndryshim nga vlerësimi i mëparshëm, këtë herë, programi i shkëmbimit Erasmus ka lehtësuar këtë shkëmbim, pasi ofron financim të mjaftueshëm si për kërkuesit, po ashtu edhe për studentët **[RVV, f.29]**. Është e qartë se qëllimi i universitetit është të bashkëpunojë kryesisht me institucionet e bazuara në BE, pasi ato ofrojnë mbështetjen e nevojshme për realizimin e qëllimeve të UBT-së për kërkimin dhe ndërkombëtarizimin. Në këtë drejtim, përmes përkrahjes së BE-së (Projekti STEPS), UBT-ja po zbaton një program rajonal për të krijuar një program Master Shkencor në sisteme të prodhimit të qëndrueshëm ushqimor **[RVV, f.29]**. Duke qenë se ky projekt bën bashkë aktorët kombëtarë dhe rajonalë në bashkëpunim për zhvillimin e një programi studimi që do të çojë përpara akademinë dhe industrinë, grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron një **praktikë të mirë. [Kapitulli III, Standardi III.2].**

- 1.10 Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët e jashtëm kombëtarë, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se UBT-ja ka një pozicion veçanërisht të favorshëm, pasi shumë prej drejtuesve të institucioneve shtetërore me të cilët ka gjasa të bashkëpunojë janë alumni të UBT-së. Ajo çka është më e rëndësishme është se dhe disa nga drejtuesit e sipërmarrjeve private janë alumni të UBT-së dhe grupi i vlerësimit të jashtëm u informua se ishin të gatshëm të bashkëpunonin me universitetin, veçanërisht për sa u përket praktikave mësimore dhe punësimit të të diplomuarve **[BM11 Mbledhja me partnerët e jashtëm dhe alumni]**. U bëmë me dije rreth disa praktikave në zbatim dhe vështirësive që hasin. Megjithatë, në përputhje me pikën 1.8 dhe 1.9 më lart, ky bashkëpunim duhet të jetë më përfshirës në veprimtaritë e përditshme të UBT-së, veçanërisht në nivel departamenti. Bashkëpunimi i strukturuar, që çon në sigurimin e pozicioneve të punës për studentët, duhet të konsiderohet si finalizimi i proceseve të gjata të bashkëpunimit, që përfshijnë, por pa u kufizuar, studimet e tregut, shqyrtimet dhe hartimet e kurrikulave, hapjen dhe riorganizimin e programeve,

etj. Pavarësisht kësaj, grupi i vlerësimit të jashtëm nënvizon si një **praktikë të mirë** faktin se UBT-ja ka finalizuar dhe po shton marrëveshjet me çdonjëren nga 61 bashkitë e Shqipërisë, për të bërë të mundur zhvillimin e praktikave profesionale për studentët dhe për ofrimin e këshillimit strategjik për bashkitë lidhur me çështjet e zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm, veçanërisht për sa i përket bujqësisë **[Kapitulli III, Standardi III.3]**.

- 1.11 Universiteti këmbënguli, veçanërisht duke u bazuar te zhvillimet aktuale, se ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, si për studentët po ashtu dhe për stafin, përbëjnë një prioritet institucional kryesor **[A.5.69 deri te 5.74]**. Në përgjithësi, mobiliteti u dëshmuar dhe u mbështet përmes marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet universitetit dhe institucioneve të huaja të arsimit të lartë, si dhe përmes angazhimit me programe ndërkombëtare, si CEEPUS dhe ERASMUS+ **[A.4.35 deri te 4.55]**. Një zhvillim tepër pozitiv është financimi që do të mundësohet nga GIZ-ja për 20 kandidatë për doktoraturë, me qëllim zhvillimin e kërkimit të doktoraturës **[BM2 Mbledhja me rektorin]**. Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, grupi i vlerësimit të jashtëm, në bazë të shifrave të raportuara nga universiteti, vërejtë se mobiliteti vijonte të ishte tej mase i ulët. Nga viti akademik 2016-2017 deri në vitin akademik 2018-2019, një numër total prej 75 studentësh kishin shfrytëzuar mobilitetet në fjalë **[RVV f. 31]**. Në terma përqindjeje, për vitin akademik 2018-2019, viti i fundit akademik 'normal', 0.65% e studentëve kanë marrë pjesë në mobilitet ndërkombëtar, që nuk është një shifër e mjaftueshme për përmbushjen e standardeve.

Universiteti mundësoi dokumentacion shtesë lidhur me mobilitetin e stafit dhe studentëve, ku pasqyrohej një numër më i lartë mobiliteti **[C 1.7]**. Në këtë aspekt, dy janë çështjet me rëndësi dhe për t'u analizuar. Së pari, ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet shifrave në RVV dhe atyre të paraqitura në dokumentet shtesë të dorëzuara te grupi i vlerësimit të jashtëm. Për shembull, për vitin akademik 2017-2018, sipas RVV-së ishin 20 studentë, të cilët mbështeteshin te mobilitetet, ndërsa sipas dokumenteve shtesë, po në të njëjtin vit, numri ishte 89. Ekzistojnë mospërputhje të ngjashme edhe për vitet e tjera akademike. Kjo do të thotë se ndodh një keqkomunikim ndërmjet zyrave përkatëse, çka duhet të trajtohet sa më parë. Pika e dytë, po aq e rëndësishme, është se mobilitetet vijojnë të mbeten shumë të ulëta për një universitet të këtyre përmasave. Nëse pranojmë se gjatë vitit akademik 2017-2018 ishin 89 mobilitete studentësh, atëherë kjo përbën vetëm 1.2% të trupës studentore. Prandaj, grupi i vlerësimit të jashtëm është i mendimit se, aktualisht, UBT-ja nuk respekton plotësisht frymën dhe parashikimin e standardit III.4 të Kapitullit III. UBT-ja duhet të marrë masa proaktive për të rritur ndjeshëm numrat e mobilitetit, veçanërisht për studentët si dhe personelin; **[Kapitulli III, Standardi III.4]**.

- 1.12 Në përgjithësi, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se universiteti i përmbush standardet e cilësisë për sa i përket menaxhimit dhe organizimit. Universiteti ka organizma dhe procedura të brendshme të mirëpërcaktuara lidhur me organizimin e procedurave akademike dhe administrative. Të gjitha dokumentet kryesore të kërkuara, që drejtojnë jetën institucionale dhe akademike, ekzistojnë dhe janë të mirëhartuara. Krahas kësaj, të gjitha zyrat e nevojshme për menaxhimin e procedurave akademike dhe administrative të universitetit duket se janë funksionale. Ekzistojnë një sërë problematikash lidhur me normën e mobilitetit të studentëve, mbulimin e alumnit dhe partnerëve të jashtëm, si dhe përshtatjen e duhur me nevojat e tregut. Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se, veçanërisht duke u bazuar tek intervistat me drejtuesit e lartë të universitetit, dokumentet strategjike të UBT-së duhet të përditësohen në mënyrë koherente dhe përfshirëse, me qëllim që të pasqyrojnë më mirë orientimin aktual strategjik të universitetit drejt ndërkombëtarizimit.

Në përgjithësi, sikurse paraqitet në vijim në përmbledhjen e gjetjeve, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi 2 praktika të mira, 1 pikë të dobët, 4 rekomandime dhe 2 pohime që duhet të konsiderohen në tërësi si pjesë të së njëjtit 'kuadër', duke përcaktuar të gjithë elementet e kërkuara për një universitet modern me ambicie të shumta dhe mundësi të mëdha, si UBT-ja.



## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Zbatimi i projektit STEPS është një praktikë e mirë, që duhet të përdoret dhe zgjerohet si një model për thithjen e fondeve ndërkombëtare, mundësimin e bashkëpunimit rajonal dhe përfshirjen e palëve të interesit përkatëse në zhvillimin e programeve të studimit me bazë shkencore dhe të përshtatshme për tregun; **[Kapitulli III, Standardi III.2].**
- Marrëveshjet e strukturuar me bashkitë janë një praktikë e mirë për mundësimin e zbatimit të përshtatshëm të praktikave të mësimdhënies dhe hapjes së universitetit për të gjithë aktorët e jashtëm të përfshirë në zbatimin e dijeve të prodhuara nga universiteti lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. **[Kapitulli III, Standardi III.3].**

### Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### Rekomandimet

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UBT-ja duhet të marrë masa proaktive për të rritur ndjeshëm numrat e mobilitetit ndërkombëtar, veçanërisht për studentët si dhe personelin; **[Kapitulli III, Standardi III.4].**
- Konceptualizimi tejte i ngushtë dhe deri diku mekanik i 'angazhimit të alumnit' ka ndikuar aftësinë e universitetit për të organizuar mjedisin e jashtëm në të cilin operon, çka ka cenuar suksesin e disa prej programeve të studimit më të konsoliduara dhe të vjetra të universitetit. Prandaj, UBT-ja duhet të hartojë një strategji/plan veprimi të qartë për angazhimin dhe shfrytëzimin e alumnit të vet për të organizuar mjedisin e jashtëm në të cilin operon, si mënyrë, ndër të tjera, për të përmirësuar situatën e disa prej programeve të studimit në vështirësi (sikurse tregohet nga numri i ulët i studentëve të regjistruar); **[Kapitulli III, Standardi III.2].**
- UBT-ja duhet të rishikojë dhe përditësojë dokumentet e veta strategjike kryesore (plani strategjik i zhvillimit dhe strategjia e kërkimit) për të pasqyruar si vizionin strategjik të Rektorit, po ashtu dhe zhvillimet e vazhdueshme lidhur me bashkëpunimin e strukturuar me Universitetin e Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës së Vjenës, Austri; **[Kapitulli III, Standardi I.5].**

- UBT-ja duhet të pasurojë, institucionalizojë dhe profesionalizojë marrëdhënien me aktorët e tregut të punës dhe studimet e tregut të punës duhet të përfshijnë palë interesi të jashtme dhe të pavarura. Të gjitha departamentet e UBT-së duhet të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre me palët e jashtme të interesit për të siguruar përputhshmërinë e shërbimeve dhe programeve përkatëse të studimit me nevojat e tregut shqiptar të punës në zhvillim e sipër dhe zhvillimin e përgjithshëm. **[Kapitulli III, Standardi III.1].**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- UBT-ja po finalizon një riorganizim administrativ, bazuar në statutin e rishikuar, çka paraqet një mundësi ideale për trajtimin e pikave të dobëta të identifikuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm dhe për përfshirjen e rekomandimeve të tyre në të gjitha proceset e universitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.1].**
- UBT-ja po kalon nëpër një proces ndërkombëtarizimi të shpejtë dhe të strukturuar, sikurse pasqyrohet në marrëveshjen me Universitetin e Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës së Vjenës, Austri. Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet për të trajtuar disa nga gjetjet e grupit të vlerësimit të jashtëm për sa i përket mobilitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

### **Gjykimi**

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UBT-ja ka zhvilluar dhe miratuar grafikun organizativ, i publikuar në faqen përkatëse të internetit [www.ubt.al](http://www.ubt.al) dhe strategjinë ku përcaktohet struktura akademike e institucionit dhe rolet e stafit administrativ **[A.1.1]**. Struktura organizative është diskutuar brenda institucionit dhe është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit **[RVV, f.33]**. UBT-ja ka zhvilluar dhe ndjek politika progresive të rekrutimit të stafit akademik, si dhe ka përcaktuar kritere të qarta rregullatore për stafin akademik **[A.2.18]**. Rekrutimi në njësitë akademike mbështetet nga kërkesat prej analizave specifike të fakultetit, departamentit, programit të studimit, përkatësisht, bazuar në kurrikulat e tyre. Vendet e lira njoftohen përmes portalit në internet [\[https://ubt.edu.al/sq/2021/10/05/oferte-pune-10/\]](https://ubt.edu.al/sq/2021/10/05/oferte-pune-10/). Procesi i rekrutimit për stafin mësimdhënës, shkencor dhe administrativ ndjek të njëjtin proces të përcaktuar në Statut dhe Rregullore, që marrin në konsideratë ligjin përkatës **[A.1.42, A.2.18, RVV, f.36, A.2.23, A.2.27]**. Zyrat e burimeve njerëzore dhe shërbimeve ligjore në UBT menaxhojnë procedurat e rekrutimit dhe mbajnë kopjet elektronike dhe fizike të dokumentacionit për të gjithë stafin e IAL-së. Çdo kontratë punësimi nënshkruhet nga Rektori i IAL-së. Në përputhje me natyrën specifike të institucionit, stafi akademik aktual përbëhet nga profesionistë të kualifikuar në fusha teknike specifike të inxhinierisë. **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**
- 2.2 Plani Strategjik 2016-2025 i IAL-së mori përsipër zbatimin e politikave të integritit të stafit akademik dhe administrativ. **[A.1.1, RVV. f. 38]**. Në Raportin e Vetëvlerësimit, stafi mbështeti pikëpamjen se stafi akademik merr pjesë në një sërë veprimtarish, si kërkim, workshop-e, aktivitete të fushës dhe organizime sociale, krahas mësimdhënies. Në fillim të çdo viti akademik, IAL-ja harton një plan veprimi masash për zbatimin e detyrave, duke respektuar afatet kohore të angazhimit **[A.1.9, A1.10, A.1.11, RVV f.38]**. UBT-ja ushtron veprimtari të ndryshme për përgatitjen e fushatave informuese, si broshura informuese, faqe interneti në nivel universiteti, si dhe fakulteti, vizita në terren në nivel qarku dhe vendi **[A.5.31, A.5.36, A.5.51]** Gjithashtu, UBT-ja ka organizuar aktivitete sociale si “Happy hour”, aktivitete sportive, etj. **[A.5.93, A.5.94, A.5.95]**. **[Kapitulli III, Standardi IV.2]**
- 2.3 UBT-ja ndjek një politikë inkurajuese ndaj stafit akademik, për të promovuar përvojat akademike përmes pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme, konferenca, veprimtari kërkimore, si instrumente për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe programeve të studimit **[A2.38, A.2.34, A2.35, A2.37 RVV f.40]**. IAL-ja vlerëson stafin akademik përkatës rregullisht, duke nisur nga vetëvlerësimi i stafit akademik, më pas Departamentet, si njësi akademike parësore, vlerësojnë stafin përkatës duke krijuar raportet periodike që iu dërgohen fakulteteve. **[A.1.18, A.4.46, A.4.3, A.4.2, A.4.1]** Praktikrat e vlerësimit të stafit akademik bazohen në mësimdhënie, kërkim, punën e studentëve dhe zhvillimin profesional nga veprimtaria e pavarur. Gjatë rekrutimit të personelit akademik, UBT-ja synon t'i japë sa më shumë mundësi stafit akademik për përparim akademik nëpërmjet doktoraturave drejt titujve akademikë. Krahas ecurisë akademike, ndërkombëtarizimi, përmes një sërë instrumentesh të financuara nga BE-ja, si IPA, ERASMUS +, projektet HORIZON 2020, përbën prioritet për institucionin **[A.2.36, A.2.31, A.2.32, A.2.33]**. **[Kapitulli III, Standardi IV.3]**
- 2.4 UBT-ja ka organizuar dhe mundësuar një gamë të gjerë veprimtarish për inkurajimin e dialogut social ndërmjet stafit, studentëve dhe komunitetit të përgjithshëm **[RVV f.39]**. Stafi akademik është përfshirë në një larmi konferencash workshop dhe studentët janë angazhuar me institucionet vendore në projekte të ndryshme. Përveç kësaj, UBT-ja ka dhe një botim periodik: *Revista Shqiptare e Shkencave Bujqësore*, ku botohen artikuj, që ofrojnë kontribute shkencore dhe politikash për fushat

bujqësore. [<http://www.ajas.ubt.edu.al>]. Sikurse është lehtësisht e dukshme, IAL-ja ka një bashkëpunim të mirë të stafit administrativ lidhur me menaxhimin e situatës së pandemisë dhe përhapjes së COVID-19 duke ruajtur distancën dhe duke kontrolluar temperaturën e studentëve dhe personelit. Gjatë vizitës në ambient të grupit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se disa mjedise, si kopshti përpara ndërës prej godinave kryesore, bënte bashkë institucionin dhe komunitetin në mënyrë të strukturuar dhe organike [RVV. F. 39]. **[Kapitulli III, Standardi IV.4].**

- 2.5 Një numër i konsiderueshëm programesh studimi të IAL-së janë të akredituara dhe ky akreditim vërteton se UBT-ja siguron menaxhim efikas të stafit akademik për të mos cenuar asnjë nga lëndët e programeve të studimit. Grafiku organizativ i IAL-së [A1.28] është i qartë për sa i përket organizimit të brendshëm, ku përfshihen njësitë akademike, zyrat në universitet, si dhe organet kolegjiale. Në IAL ndodhet një zyrë për burimet njerëzore dhe për shërbimet ligjore, që menaxhon edhe dosjet e stafit akademik. Fakultetet menaxhohen në mënyrë të pavarur nga Dekani, në të cilët ndodhen edhe departamentet. Në këtë organizim, gjatë vizitës në UBT, u vëzhgua një praktikë në funksionimin e departamentit, që kryesohet nga drejtuesi i departamentit. Në Fakultete dhe departamente, ekzistojnë rregullore që ndihmojnë me organizimin dhe shpërndarjen e qartë të përgjegjësisve sipas funksioneve. IAL-ja ka shumë rregullore funksionale [A.1.75, A.1.42] të organeve kolegjiale, ku përcaktohen qartësisht detyrat dhe detyrimet e personave drejtues. **[Kapitulli II, Standardi II.2].**
- 2.6 Buxheti i UBT-së respekton të gjitha procedurat e përcaktuara, duke filluar nga departamenti, që projektin nevojat buxhetore dhe i reflekton ato më tej, te fakulteti, që harton procedura të mëtejshme miratimi, deri te Bordi i Administrimit [A.2.54]. UBT-ja ushtron autonomi financiare, në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit të financave publike. Buxheti i IAL-së sigurohet ose financohet kryesisht nga buxheti i shtetit dhe fondet e vetësiguruara, si tarifat studentore apo shërbimet e ofruara kundrejt partnerëve dhe donatorëve [RVV, f.40]. UBT-ja, duke respektuar ligjin shtetëror për buxhetin, ka përgatitur një raport të rregullt për vitin e realizimit të buxhetit [A2.55]. Procesi i hartimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit administrativ financiar është i mirëstrukturuar, eficient dhe i njohur për stafin. Shpërndarja e buxhetit të IAL-së është miratuar në organet kolegjiale, si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Duke qenë se menaxhimi financiar dhe kontrolli buxhetor janë të centralizuar, **njësitë akademike nuk zotërojnë autonomi të plotë financiare.** Megjithatë, transparenca sigurohet nëpërmjet diskutimit të çështjeve financiare në Senatin Akademik, ku marrin pjesë stafi dhe përfaqësuesit e studentëve. Buxheti i IAL-së u shpërndahet të gjitha njësisve akademike dhe Rektoratit [A2.50]. **[Kapitulli III, Standardi VI.1].**
- 2.7 UBT-ja ka krijuar strukturën e menaxhimit financiar të rregullt për zbatimin e politikës financiare përmes strukturës së miratuar nga Bordi i Administrimit [A.2.5, RVV. f.43]. IAL-ja respekton të gjitha procedurat shtetërore të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin paraardhës dhe, për vitin financiar pasardhës, përgatit shpenzimet për zërat buxhetorë dhe të ardhurat që kalojnë në të gjitha njësitë akademike, duke filluar nga departamenti, fakulteti, senati dhe bordi i administrimit [A.1.41]. IAL-ja ka detyrimin ligjor që të hartojë raportin vjetor të auditimit financiar. IAL-ja iu nënshtrohet auditimeve financiare të jashtme, si dhe atyre financiare periodike, të brendshme [A2.56]. Raportet e auditimit miratohen nga organet kolegjiale të Universitetit, si Senati dhe bordi i administrimit. Zyra e Financës dhe Buxhetit mbikëqyr të gjitha detyrimet financiare të institucionit, krijimin e pasqyrave financiare të institucionit, si dhe hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për financat. IAL-ja përbëhet nga struktura funksionale, që menaxhojnë buxhetin dhe krijojnë raporte financiare sipas ligjeve dhe detyrimeve fiskale të Shqipërisë. Në

përputhje me ligjin kombëtar, UBT-ja dorëzon pasqyra financiare në bazë vjetore tek institucionet shtetërore (MUA dhe Thesari i Tiranës) **[RVV f.43]. [Kapitulli III, Standardi VI.2, Kapitulli III, Standardi VI.3].**

- 2.8 UBT-ja posedon një sistem menaxhimi të koordinuar informacioni. Krahas faqes kryesore të internetit, secili fakultet ka një faqe të posaçme interneti për nevojat e studentëve dhe stafit përkatës **[RVV f. 44-45, [www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)]**. Megjithëse faqja institucionale e internetit ofron një vështrim gjithëpërfshirës dhe informacion strategjik, informacionet dhe njoftimet publike lidhur me nevojat akademike të Njësisë kryesore dhe bazë paraqiten në faqe të posaçme. Gjithashtu, faqja e IAL-së përbëhet nga përmbajtje universitare ku palët e interesuara njihen me organet kolegjiale, drejtuesit e universitetit dhe dokumentet funksionale të universitetit, si: Statuti, rregulloret, anëtarët e stafit akademik, administrimi, kurrikulat e studimit dhe një sërë dokumentesh të tjera të UBT-së **[RVV, f.44]**. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), që i ofron Universitetit hapësirë në bazën e të dhënave për mësimdhënien, mësimnxënien, kërkimin, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. Për sa u përket nevojave të shërbimeve për studentët, stafit akademik në lidhje me studentët, IAL-ja përdor platformën elektronike SMS ESSE3 **[A.5.56]**, konkretisht **[<https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al>]** për Menaxhimin e Studentëve. **[Kapitulli III, Standardi VII.1].**
- 2.9 UBT-ja është angazhuar për zhvillimin e infrastrukturës së vet digjitale në mbështetje të të nxënit të studentëve dhe zhvillimit profesional të stafit akademik **[Mbledhja1]**. Në UBT ka një sektor informacioni, TI-je dhe mirëmbajtjeje, që kujdeset për fushën e teknologjisë së informacionit për të pasqyruar veprimet e njësisë akademike dhe departamenteve të tyre me orët e mësimin, oraret e provimeve, njoftimet për veprimtaritë akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit **[A.1.28]**. Në mjediset e Universitetit gjenden laboratorë TI-je për të zhvilluar mësimdhënien dhe për t'u ofruar studentëve mbështetje për përgatitje. Për shkak të pandemisë, mësimdhënia është zhvilluar në formë virtuale dhe mësimdhënia e stafit akademik në mjediset e fakultetit mund të konsiderohet një praktikë e mirë **[RVV f.49]**. UBT-ja ofron një gamë laboratorësh kompjuterikë të pajisur me pajisjet e nevojshme për të mbështetur të nxënit e studentëve dhe procesin mësimor në përgjithësi. **[Kapitulli III, Standardi VII.2].**
- 2.10 UBT-ja ka një regjistër të pasurisë së paluajtshme, që shtrihet në disa hapësira në "Kodër Kamëz", Tiranë. **[A.2.55]** Kampusi universitar i UBT-së ndodhet në zonën e Kamzës në qytetin e Tiranës dhe përbëhet nga disa objekte të posaçme, të vendosura pranë njëra-tjetrës **[A2.62, A.2.59]**. Disa prej godinave janë të vjetra (të ndërtaura dekada më parë). Kampusi i IAL-së, përkatësisht dy nga godinat (Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe Fakulteti i Shkencave Pyjore) pësuan dëmtime të rënda strukturore nga tërmeti i vitit 2019, dhe godina e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit është duke u ndërtuar **[RVV f.48]**. Godinat që u bënë të papërdorshme pas tërmetit janë duke u rindërtuar. Drejtoria e brendshme e IAL-së për fondet dhe investimet menaxhon pronën e universitetit duke zhvilluar procedura tenderimi dhe prokurimi, çka bëjnë të mundur zbatimin e planit strategjik institucional **[A.1.1, RVV f.48]**. Investimi vjetor siguron mirëmbajtjen e infrastrukturës së UBT-së në standardin e kërkuar dhe grupi i vlerësimit të jashtëm dëshmoi cilësinë e infrastrukturës mësimore dhe aksesin e posaçëm për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se IAL-ja i menaxhon asetet, kampusin universitar, godinat dhe kapitalin tjetër të paluajtshëm në nivel të pranueshëm funksionaliteti **[Tur në burimet e të nxënit]**. Në zonat ku nuk ka akses për personat me aftësi të kufizuara, është hartuar një plan veprimi për trajtimin e kësaj problematike. Grupi i vlerësimit të jashtëm **ripohon** masën e propozuar nga UBT-ja për sigurimin se të gjithë studentët, dhe personat me aftësi të kufizuara në veçanti,

- do të kenë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. **[Kapitulli III, Standardi VII.3].**
- 2.11 Mësimdhënia organizohet dhe zhvillohet në gjuhën shqipe në të gjitha programet e studimit. IAL-ja ndjek politikën e trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore duke organizuar leksione të hapura me tematika që kanë të bëjnë me fushat e studimit të UBT-së. Veprimtaria e IAL-së lidhur me studimet, botimet, konferencat shkencore, etj., konsiderohet një vlerë e shtuar e UBT-së, duke kontribuar në pasurinë kombëtare. IAL-ja punon për të përcaktuar periodikisht politikat më të përshtatshme për ruajtjen dhe njohjen e publikut me trashëgiminë akademike, kulturore dhe shkencore të UBT-së **[RVV f.48]. [Kapitulli III, Standardi VII.4].**
- 2.12 Ka dhjetë godina ekzistuese të kampusit, ku sigurohen kushte dhe hapësirë fizike e mjaftueshme për procesin e vazhdueshëm të mësimdhënies, veprimtaritë laboratorike, etj., në mënyrë të pavarur dhe të pandërprerë. Krahas kësaj, IAL-ja ka hartuar strategji për përmirësimin e cilësisë së aseteve për studentët. Çdo vit, kryhen investime për efekt të riparimit të mjediseve të universitetit, përkatësisht të objekteve të fakulteteve specifike. Sipërfaqja e hapësirës në të cilën UBT-ja organizon dhe ushtron proceset e funksioneve përkatëse është 10.230,15m<sup>2</sup> **[A2.59]** ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve është 1936 **[A.259]**. Sipërfaqja konkrete e objektit për një student, duke marrë në konsideratë veprimtaritë me tre turne mësimore, është 5.28m<sup>2</sup>. Gjatë vizitës në IAL, në mbledhjet e mbajtura **[M10]**, në hapësirat e fakulteteve ofrohet akomodim cilësor për studentët për sa i përket ngrohjes/ftohjes së mjediseve. **[Kapitulli III, Standardi VII.5].**
- 2.13 Gjithashtu, IAL-ja ofron shërbime të tjera jashtë procesit të të nxënit të strukturuar për palët e treta, me qëllim rritjen e buxhetit nga të ardhurat e tregut. **[A.2.81, A.2.63, RVV, f.49]**. Mjediset e kampusit janë të mirëmbajtura dhe investimet e UBT-së në kujdesin dhe cilësinë e shërbimeve me mirëmbajtjen e mjediseve janë të dukshme. Klasat janë të pajisura me mjete të përparuara për konkretizimin e të nxënit. Laboratorët e TI-së janë të pajisur me kompjutera të gjeneratës së fundit. **[Kapitulli III, Standardi VII.6].**
- 2.14 Godinat e kampusit të UBT-së ndodhen në një pjesë të kompleksit të rrethuar nga hapësira të gjelbra, ku sigurohet ndalim i zhurmave akustike, përkatësisht zhurma nga rruga kryesore përthithet nga barrierat e gjelbra përgjatë rrugës dhe largësia e godinave nga rruga është e tillë që zhurma që vjen prej saj reduktohet në minimum. Gjatë vizitës në mjediset e IAL-së **[Tur në burimet e të nxënit]**, përkatësisht në mjediset e Universitetit; konkretisht, fakultetet, departamentet, klasat, laboratorët, objektet sanitare, u vu re se mirëmbajtja është cilësore. Fasadat e godinave janë të versionit klasik, me shtresa me aftësi izolimi termik, efekte akustike, si dhe eficiente ndaj humbjes së energjisë. Organizimi i godinave të UBT-së në kampus ofron mundësi për zhvillimin e veprimtarive të të nxënit në mënyrë të pavarur, duke siguruar pavarësinë e njërive të mësimdhënies. Hapësirat e brendshme të godinës janë ndërtuar me materiale cilësore dhe janë tepër eficiente për t'u mbajtur pastër. Objektet sanitare, komunikimi vertikal dhe korridoret ndriçohen nga dritë natyrale. Instalimet elektrike, ndriçimi dhe ngrohja-ventilimi funksionojnë në nivelin maksimal të kërkesave të godinës. Lartësia e brendshme e kateve është rreth 3.5m, duke qenë e mjaftueshme dhe duke përmbushur standardet përkatëse për këtë kategori godinash. Bibliotekat ofrojnë mjedise të këndshme pune me organizim përmbajtjeje që përmbush funksionin përkatës. Mjediset e punës kanë ventilim artificial, çka u bën të mundur të shfrytëzohen pavarësisht kushteve atmosferike dhe dendësisë së përdorimit të hapësirës. Raporti i sipërfaqes së godinës me numrin e përdoruesve është 5.28 **[A2.59]** m<sup>2</sup>/student, duke përmbushur kështu standardet shtetërore. Mjediset e punës kanë ventilim artificial, çka u bën të mundur të shfrytëzohen pavarësisht kushteve atmosferike dhe dendësisë së përdorimit të hapësirës.

Organizimi i secilës godinë të fakulteteve në katin e hyrjes është shumë bashkëkohor, duke siguruar orientim efikas në hapësirë dhe pika njoftimesh për veprimtaritë e ndryshme që zhvillohen në godinë. Sistemi i ngrohjes kombinohet me atë qendror përmes ftohësve dhe njërive ngrohëse të vendosura në klasa. Godinat kanë projektim cilësor në rast zjarri dhe janë të siguruara kundër zjarrit. **[Kapitulli III, Standardi V.1].**

- 2.15 IAL-ja ka një sistem të organizuar për ruajtjen e dokumenteve dhe dokumentacionit në format elektronik ose të shtypur. Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës, ishte e qartë se tregohej kujdesi i duhur ndaj dokumentacionit të bibliotekës, si dhe ndaj arkivimit fizik dhe elektronik të tij. Gjithashtu, të dhënat individuale të studentëve ruhen nga sekretaritë e fakulteteve, përkatësisht në shërbimin ESSE3, që mundëson bazën elektronike për të gjitha të dhënat e studentëve **[Kapitulli III, Standardi V.2]**

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UBT-ja duhet të krijojë një mekanizëm/instrument monitorimi dhe përditësimi periodik për faqen institucionale të internetit dhe të gjitha faqet e internetit të fakulteteve, për të siguruar se informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, aktual dhe i saktë. **[Kapitulli III, Standardi VII.1].**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- UBT-ja tregon vëmendje dhe kujdes për të siguruar se godinat (e vjetra), që nuk ofrojnë akses të pakufizuar për personat me aftësi të kufizuara, do të përshtaten në përputhshmëri të plotë me kërkesat përkatëse. **[Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1]**

## **Gjykimi**

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**



### Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 UBT-ja ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe kapacitetet përkatëse. IAL-ja ofron një gamë të gjerë programesh studimi bazë të mirëprojektuara dhe, në përfundim të studimeve, studenti zgjedh të kërkojë mundësi punësimi në tregun e punës, ose të vazhdojë në nivelin e programeve Master. Aktualisht, janë 6 programe profesionale studimi dyvjeçare, 24 programe studimi Bachelor, 22 programe Master Profesional, (15+1) programe Master Shkencor, 1 program studimi i nivelit të tretë Master Ekzekutiv dhe 5 programe studimi doktorature **[A.3.1]**. Të gjitha programet e studimit janë hartuar nga 5 fakultetet me 19 Departamentet **[A1.41]**. UBT-ja i publikon programet e studimit në të gjitha nivelet (BSc, Msc, MP dhe PhD) në faqen e internetit [<http://ubt.edu.al/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/doktorature-fbm/>], dhe disa nga këto programe janë të akredituara nga institucionet e posaçme [[www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit](http://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit)]. Të pesta fakultetet ofrojnë lëndë akademike në fushën e bujqësisë, ekonomisë bujqësore, pylltarisë, ushqimit, veterinarisë dhe mjedisit **[A.5.25, RVV f.57]**. UBT-ja siguron se kurrikulat janë hartuar për të mbështetur ecurinë e të nxënësve të studentëve në të gjithë programin. Detajet e secilit program, si synimet, objektivat, struktura e kursit dhe vlera e krediteve janë të disponueshme në faqet e internetit të fakulteteve, që mund të aksesohen përmes faqes kryesore të internetit [[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)]. IAL-ja analizon dhe harton strategji **[A1.1]** dhe politika që lidhen me krijimin e mundësive të studimit përmes konkurrencës dhe përgatitjes profesionale për pozicionimin sa më të mirë të studentëve në tregun e punës **[A.4.74]**. Programet e studimit në UBT zhvillohen në gjuhën shqipe dhe nuk ka asnjë student ndërkombëtar me kohë të plotë në UBT. IAL-ja ka një strategji për ndërkombëtarizimin e universitetit **[A1.1]**. Procesi i pranimit është i përcaktuar qartë, i publikuar në broshura dhe në faqen e internetit dhe i kuptuar nga studentët, dhe të gjithë aplikantët trajtohen në mënyrë të drejtë dhe gjykojnë në bazë merite, duke marrë parasysh arsimin e mëparshëm, provimet e shtetit dhe testet e organizuara nga njësitë akademike. IAL-të ndjekin një politikë për regjistrimin e studentëve, që merr në konsideratë peshën specifike të studimeve bazë në shkollat e arsimit të mesëm në programet e tyre **[RVV f.57]**. **[Kapitulli I, Standardi I.1].**
- 3.2 Misioni i IAL-së është të mësojë dhe formojë specialistë dhe shkencëtarë në përputhje me tendencat bashkëkohore, duke iu ngarkuar njësitë akademike përgjegjësinë për zhvillimin dhe funksionimin e programeve të studimit që synojnë arsimin gjatë gjithë jetës. **[A1.42]**. Programet e studimit BSc në UBT kanë vijimësi, duke ofruar programe studimi të nivelit MSc në të njëjtat fusha. Gjithashtu, IAL-ja ofron programe studimi për profesionistë përmes programeve dyvjeçare të studimit dhe nivelet e Masterit Profesional për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. UBT-ja u ofron studentëve arsim të vazhdueshëm edhe pas diplomimit, në bazë të kërkesave të tyre, pa shpëputje nga puna, sikurse është programi i studimit Master Ekzekutiv. IAL-ja organizon kualifikime profesionale në mënyrë të vazhdueshme, për shembull, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ofron kurse formimi profesional “Agjent i Zhvillimit Lokal ADL” **[RVV f.59]**. **[Kapitulli I, Standardi I.2].**
- 3.3 Programet e studimit janë hartuar në përputhje me procesin e Bolonjës, për sa i përket strukturës, nivelit dhe krediteve për të gjitha ciklet e studimit. Për nivelin e tretë të studimeve të doktoraturës, UBT-ja i ka riorganizuar sipas kushteve ‘të reja’ të ligjit **[RVV f.60, A.1.2]**. Studentët janë të mirinformuar rreth programeve të tyre të studimit, aftësive që fitojnë pas diplomimit dhe diplomave përkatëse. Studentët dhe stafi pohuan se u ofrohen mundësi mobiliteti ndërkombëtar, po ashtu dhe ndihmë financiare në disa raste. **[Kapitulli I, Standardi I.3].**

- 3.4 IAL-ja ofron programe studimi që respektojnë politikat e përgjithshme kombëtare dhe planin strategjik përkatës për kërkimin shkencor **[A.1.1, A.1.2]** dhe se përmbajtja e programeve të studimit u ofron studentëve dhe pedagogëve mobilitet **[A.2.31, A.2.36, A.2.32, A.2.33]** në një gamë të gjerë universitetesh ndërkombëtare. IAL-ja ka përcaktuar veprime me prioritete dhe synon të arrijë konsolidimin e programeve të studimit, bashkëpunim me universitete të tjera vendase dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunim me institucionet nga tregu i punës. Ky është tregues i qëllimeve dhe misionit të UBT-së për të përmirësuar në vazhdimësi ofertën e vet akademike. **[Kapitulli I, Standardi I.4].**
- 3.5 UBT-ja e konsideron kapacitetin lidhur me infrastrukturën, punësimin e stafit dhe financat si pjesë të procesit të hartimit të programeve të reja. Secili departament planifikon mësimdhënien çdo vit, sipas akteve nënligjore në fuqi, dhe raporton në fund të vitit për zbatimin kundrejt planit. **[RVV f.61, A1.42, A.1.1, A.1.2].** E gjithë mësimdhënia shtesë nga stafi me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme financohet tërësisht nga Universiteti **[RVV f.61, A.2.13].** Stafi akademik ka marrëveshje vjetore në të cilat bien dakord për kohën e shpenzuar për mësimdhënie, punë kërkimore apo detyra të tjera. Disa nga stafi akademik kanë detyra administrative dhe angazhimet individuale të mësimdhënies reduktohen në mënyrë proporcionale **[Kapitulli I, Standardi I.5].**
- 3.6 Kurrikula e programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike gjendet në faqen e internetit të Universitetit [www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al). Ndërsa, në faqen elektronike të internetit [www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit](http://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit) mund të shihet lista e programeve të akredituara **[RVV f.61].** Gjatë procesit të vlerësimit, u konstatua se faqja e internetit e IAL-së ishte duke u ndryshuar dhe se, përpara kësaj, faqes i mungonin programet mësimore të kurseve, që i rekomandohet universitetit t'i ngarkojë në sistem, megjithëse GVJ-ja pohon se, sipas mbledhjeve me studentët **[M.2-4],** programet mësimore të kurseve shpërndahen rregullisht. Objektivat e programeve të studimit janë në përputhje me objektivat e përgjithshme të Institucionit. Kriteret e pranimit të studentëve respektohen sipas legjislacionit dhe kuotave në nivel shteti, të cilat publikohen në faqen e internetit të universitetit. **[Kapitulli I, Standardi I.6].**
- 3.7 Të gjitha programet e ciklit të parë mundësojnë kalimin në programet e ciklit të dytë master shkencor ose profesional **[RVV f.62, A.1.43, A.3.2].** Studentët e ciklit të parë dhe të dytë pohuan se programet e ciklit të parë ofrojnë nivele njohurish bazë, metoda të përgjithshme shkencore dhe parime që u bëjnë të mundur studentëve të përfundojnë me sukses programin e ciklit të parë dhe të vijojnë me studime të mëtejshme. **[Mbledhjet 2&3]** Përfshirja e stazheve profesionale në programet e ciklit të parë u siguron studentëve përvojë të vlefshme pune dhe mundësi punësimi në të ardhmen. Partnerët e jashtëm konfirmuan se studentët, të cilët përfundojnë me sukses një stazh, përgjithësisht kalojnë në punësim të plotë pas përfundimit të programit përkatës. **[M.12]** Statuti **[A1.42]** dhe rregulloret e UBT-së u mundësojnë studentëve transferimin ndërmjet programeve dhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë. **[A.3.26, A.3.25] [Kapitulli I, Standardi I.7].**
- 3.8 Studentët e ciklit të parë kanë akses në një proces orientimi progresiv, që fillon përpara diplomimit në shkollë të mesme, përmes informacionit të mundësuar në faqen e internetit të UBT-së dhe panairëve dhe fushatave të rekrutimit. **[RVV f.63, M2, www.aut.edu.al]** Programet e ciklit të parë përmbajnë një larmi metodash mësimdhënieje në varësi të strukturës së programit, ku përfshihet puna laboratorike, vendosjet, projektet dhe, gjatë vitit 2020, rritja e përdorimit të të nxënies virtual në internet. **[RVV f.63, M3]** Rregulloret e UBT-së përcaktojnë kërkesat e kualifikimit për stafin akademik, ku kualifikimi minimal është diploma Master Shkencor. Mbi 70% e stafit me kohë të plotë është angazhuar në mësimdhënien për studentët e ciklit të parë. **[RVV f.63, A.4.28, A.4.29, A.2.15, A2.14] [Kapitulli I, Standardi I.8].**

- 3.9 Angazhimi i stafit akademik në departamentet e tyre përbën prioritet për mësimdhënien dhe kërkimin. Stafi akademik që jep mësim në programet e ciklit të dytë duhet të ketë kualifikim minimal në nivel doktore [RVV f.63, A.4.28, A.4.29]. Megjithëse prioriteti i stafit akademik është mësimdhënia dhe kërkimi, ata përfshihen në një sërë veprimtarish të tjera, si hartimi i programeve të studimit, krijimi i raporteve të vetëvlerësimit, puna në komisione, praktika profesionale dhe bashkëpunimi me partnerët e jashtëm. Programet Master Shkencor dhe disa programe Master Profesional përfshijnë një tezë si formë përfundimtare vlerësimi për testimin e aftësive dhe kompetencave profesionale të studentëve në fushën përkatëse. Sipas rastit, ofruesit e jashtëm të praktikës marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentëve. [A.3.31, A.1.47, A.1.74, A1.54, M.2] [Kapitulli I, Standardi I.9].
- 3.10 UBT-ja siguron se të gjitha programet e studimit hartohen dhe zhvillohen sipas procesit të Bolonjës dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ndërkohë që kreditet e fituara në UBT dhe jashtë vendit janë të njohura në Rregullore [RVV f. 63-64, A1.43, M.5&11]. Në këtë mënyrë, programet e studimit lehtësojnë mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë [RVV f. 64, A.1.43, A1.18, A.1.43, A.3.19 M.10&11]. Studentët e suksesshëm në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë japin provim të gjuhës angleze ose gjuhëve të tjera sipas kërkesës ligjore, dhe studentëve u jepet një diplomë dhe suplement diplome në gjuhën shqipe dhe angleze. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, gjatë takimeve me studentët e ciklit të dytë [M.3] të studimeve konstatoi se njohuritë e gjuhëve të huaja janë të kënaqshme, por edhe statuti [A.1.42] përcakton kritere për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, që parashikojnë se studenti duhet të dijë të paktën njërën nga gjuhët e BE-së, si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht [RVV f.64, A.3.30, A.1.42, M.11] [Kapitulli I, Standardi I.10].
- 3.11 Programet e studimit të të gjitha cikleve të studimit në UBT përfshijnë në kurrikulat e tyre përkatëse praktikën profesionale dhe stazhin. Sipas rastit, hartimi dhe përmbajtja e programit i përgatit studentët për mundësi profesionale dhe stazhi [RVV f.64, A.3.13, A.3.15, A.3.11, M. 1,2,3&11]. Integrimi i zbatimit praktik dhe njohurive teorike në programet e studimit arrihet përmes rasteve studimore, punës laboratorike, detyrave praktike dhe projekteve, praktikës profesionale dhe temës përfundimtare apo projektit kërkimor. Studentët vlerësuan stafin akademik dhe për mbështetjen e ofruar gjatë studimeve të tyre. [M. 2-4] Stafi akademik dhe studentët e njohin ngarkesën e punës dhe kuptimin e ECTS-së në programet e tyre. [Kapitulli I, Standardi I.11].
- 3.12 Përmbajtjet e programeve të studimit përkrahen nga misioni i IAL-së, që mbështet kërkesat e tregut të punës. Programet e studimit në të gjitha nivelet u ofrojnë studentëve kompetenca profesionale të veçanta dhe të përgjithshme, që garantojnë pozicionim të mirë në tregun e punës [RVV f.64, M.12]. Studentët u shprehën se stazhet janë një mënyrë e rëndësishme për ta, për të fituar aftësi në zbatimin e teorisë në praktikë si dhe aftësi punësimi [M 2-4]. Më e rëndësishmja, partnerët e jashtëm janë të përfshirë në ofrimin e stazheve, në vlerësimin e studentëve, në këshillimin për përmbajtjen e kursit dhe në hartimin e programeve të reja [M. 12]. [Kapitulli I, Standardi I.12]

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra.

## **Gjykimi**

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi

- 4.1 UBT-ja ofron programe studimi që përkojnë me vizionin, misionin dhe objektivat institucionale [RVV, f.70]. Programet e studimit janë të mirëdokumentuara, zbatohen në kushte të përshtatshme dhe janë në përputhje me rregulloret e institucionit [A.1.42, A.1.43]. Kurrikulat dhe programet mësimore të moduleve ndjekin një model të standardizuar, që përfshin kreditet ECTS, objektivat e të nxënit, ngarkesën e punës së studentëve, tipologjinë, literaturën dhe vlerësimin [A.3.2-A.3.9]. Grupi i vlerësimit konstatoi se numri më i madh i studentëve është në drejtimin që nuk ka qenë i zakonit për këtë universitet (FEA me 40.1% të numrit të përgjithshëm të studentëve). Në takimin me stafin drejtues, u nënvizua se kjo kërkohet nga ekonomia e tregut dhe se bujqësisë i nevojitet më tepër ekspertizë ekonomike [BM2, BM10]. Institucioni mundëson kapacitete infrastrukturore të mjaftueshme për zbatimin e programeve ekzistuese në formimin praktik dhe profesional të studentëve. Stafi akademik zotëron kualifikimet e përshtatshme për arritjen e objektivave të cilësisë së mësimdhënies [A.4.3]. Menaxhimi i procesit mësimor realizohet në nivelin e njëjësive kryesore, që bëjnë të gjitha parapërgatitjet për procesin mësimor [A.3.21]. Politikat e universitetit përcaktojnë numrin maksimal të studentëve në leksionet në grup dhe ushtrimet laboratorike. Njëkohësisht, këto politika përcaktojnë format e mësimdhënies (leksione, ushtrime / seminare, laboratorë, detyra / projekte dhe praktika lëndore) [RVV, f.71]. Në përfundim të cikleve të studimit, studentët zhvillojnë një stazh profesional në institucione të ndryshme me të cilat UBT-ja ka marrëveshje bashkëpunimi [A.3.15]. UBT-ja u ka vendosur studentëve në dispozicion literaturën e nevojshme për programet përkatëse të studimit, duke përfshirë platformat e bibliotekave digjitale [RVV, f.72]. Procesi i të nxënit gjatë COVID-19 u zhvillua në internet përmes platformave Google Meet / Classrooms dhe Zoom [A.3.33], duke përbërë sfidë për funksionimin e pjesës së praktikës laboratorike në veçanti. Në takimin me studentët e universitetit, gjysma prej tyre ishin të pavaksinuar kundër COVID-19-ës, ndërsa studentët e cikleve të tjera dhe stafi me të cilin u zhvilluan mbledhjet kishin përqindje më të lartë vaksinimi [BM1-12]. Për të rritur numrin e studentëve të vaksinuar, çka do të ndikojë në ecurinë e procesit mësimor, por edhe në mobilitetin e studentëve, grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që niveli drejtues të kontaktojë profesorë nga Fakulteti i Mjekësisë për të mbajtur një leksion me studentët e universitetit, me qëllim trajtimin e hezitimit të tyre për t'u vaksinuar [Kapitulli I, Standardi II.1].
- 4.2 Kriteret dhe procedurat për kryerjen e provimeve përcaktohen nga rregulloret e brendshme [A.1.43]. Studentët janë të informuar për procedurat e vlerësimit të njohurive të tyre, që, në shumicën e rasteve, marrin në konsideratë rezultatet e vlerësimit të vazhdueshëm, dhe jo vetëm provimin përfundimtar. Studentët kanë akses në rezultatet individuale përmes sistemit elektronik, duke respektuar kriterin e konfidencialitetit [A.5.67]. Ata njohin procesin e ankimimit të rezultateve të provimeve, që kryhet nëpërmjet procedurave të paracaktuara nga rregullorja e institucionit [A.1.44]. UBT-ja njofton kriteret dhe procedurat e diplomimit, që bazohen në rregulloren e institucionit, si dhe specifikat e fakulteteve, duke i afishuar ato në vende të dukshme [A.1.87]. Në përputhje me rregulloret e studimit, UBT-ja u jep studentëve, të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, diplomën përkatëse, që është një dokument zyrtar [Kapitulli I, Standardi II.2].
- 4.3 Programet e studimit janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm në funksion të rritjes së cilësisë [RVV, f.73]. Sigurimi i cilësisë është një proces dinamik që zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë, me të cilin janë përshtatur rregulloret institucionale [A.3.11]. Programet e studimit vlerësohen me anë të anketave periodike të studentëve, përmes së cilave identifikohen

problematikat kryesore, nga informacioni i mbërritur nga ASCAL-i përmes anketës kombëtare të studentëve, nga studimi i tregut dhe problematika të tjera të identifikuar gjatë vitit shkollor. Shtesat dhe përmirësimet e programeve ndjekin rregulla të paracaktuara me një sërë lidhjesh në proces **[A.3.11, BM1, BM2, BM10]**. Stafit akademik u nënshtrohet vlerësimeve periodike dhe të rregullta nga strukturat e institucioneve, si NJSBC-ja, që përgatit pyetësorët për studentët, duke i përfshirë ata në vlerësimin e stafit dhe të gjithë treguesit e mësimdhënies **[A.4.17-4.19, A.4.22, A.4.26]**. Ky proces zhvillohet në përfundim të ciklit modular dhe përpara provimit, por, në një takim me stafin akademik, u arrit në përfundimin se në 2 vitet e fundit nuk është kryer asnjë vlerësim dhe se përgjegjësi i departamentit përpunon raportet e studentëve për vlerësim **[BM6]**. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon se kjo praktikë duhet të kryhet nga zyra përkatëse e sigurimit të cilësisë. Grupi i vlerësimit konstatoi se në vlerësimin e studentëve të FMV-së, të zhvilluar në vitin 2019, u shfaqën disa rezultate shqetësuese **[A.4.17]**. Në pyetjen e parë vlerësuese lidhur me kushtet e përgjithshme të të nxënit, në tre nga pesë kurset që studentët ndjekin në këtë universitet, kriteri i vlerësimit DOBËT ishte më i shpeshti. Në kursin II, ky mendim ndahej nga 42.4% e të pyeturve, ndërsa në kurset III dhe IV, kjo përqindje ishte përkatësisht 39.7% dhe 44.5%. Sipas studentëve, problematikat më të mëdha në këtë fushë janë mungesa e laboratorëve, kushtet e papërshtatshme të punës dhe mjetet mësimore. Në fushën e vlerësimit të strukturave mbështetëse, përgjigja më e shpeshtë nga studentët ishte DOBËT; në kurset I-IV, ky kriter kishte përkatësisht përqindjet vlerësuese vijuese: 33.7%, 42.2%, 39.5% dhe 55.3%. Mbështetur në të njëjtin dokument, një tjetër shqetësim është mitëmarrja/mitëdhënia në lidhje me profesorët, stafin mbështetës ose administrimin. Sipas rezultateve të anketës në kursin II, ky fenomen u raportua nga 33.3% e studentëve, ndërsa 31.7% e studentëve raportuan fenomene abuzimi lidhur me profesorët në kursin V. Grupi i vlerësimit i konsideron këto rezultate nga studentët dhe mungesën e ndjekjes së tyre si **pika të dobëta** të rëndësishme institucionale. Gjatë mbledhjes me Rektorin, u diskutua edhe kjo temë dhe u shpreh gatishmëri për të trajtuar çdo rast veçmas dhe për të marrë masat e duhura për rastet e konfirmuara **[BM2]**. Cilësia e programeve vlerësohet edhe përmes statistikave të punësimit të të diplomuarve **[A.5.85, A.5.88; Kapitulli I, Standardi II.3]**.

- 4.4 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies **[RVV, f.75]** dhe e realizon këtë përmes strukturave ndihmëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (DVBSK dhe SK) **[A.1.28, A.1.29]**. Cilësia e mësimdhënies lidhet me cilësinë e stafit akademik, i cili zotëron kualifikimin dhe kapacitetin e nevojshëm. Njëra nga politikat mbështetëse është mobiliteti i stafit akademik duke fuqizuar përvojat e mësimdhënies dhe duke u mundësuar studentëve të “ndërkombëtarizohen në shtëpi” **[A.5.69-A.5.73]**. Çdo vit, organet kompetente kryejnë një analizë të detajuar të procesit mësimor, raporti i së cilës i dërgohet Rektoratit dhe më pas procesi përfundohet në MASR **[A.4.1-A.4.6, 4.13]**. Një faktor mbështetës në sigurimin e cilësisë është edhe infrastruktura e laboratorëve, që përmirësohet çdo vit përmes mbështetjes financiare, por edhe përkrahet me anë të projekteve kërkimore **[A.2.48-A.2.50]**. Pasurimi i bibliotekës dhe përmirësimi i mjedisit të të nxënit ka kontribuar gjithashtu në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Mbështetja për stafin akademik vjen edhe nga stafi ndihmës dhe administrativ, që janë po ashtu të trajnuar vazhdimisht nëpërmjet programeve ndërkombëtare **[RVV, f. 76]**. Institucioni ka në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit **[Kapitulli I, Standardi II.4]**.
- 4.5 Kërkimi është një komponent funksional i rëndësishëm i UBT-së. Qeliza kërkimore është departamenti i UBT-së, që organizohet në Grupe Mësimdhënieje dhe Kërkimi **[RVV, f. 77, A.1.41, BM8, BM10]**. Fushat kërkimore lidhen ngushtësisht me departamentet, që janë përgjegjëse për menaxhimin e financimit të kërkimeve bazë.

Kërkimi zhvillohet në përputhje me strategjinë institucionale **[A.1.1]** dhe fushat kërkimore përkatëse. Në veprimtarinë kërkimore, departamentet kanë lirinë akademike të stafit akademik. Vlerësimi i punës shkencore kryhet në bazë vjetore përmes analizës së performancës dhe më pas rezultatet bëhen publike. Plani financiar institucional siguron fondet për kërkimin shkencor **[A.2.50]** dhe pjesëmarrjen në veprimtari të tjera kërkimore. Kjo shumë është rreth 100,000 euro dhe nuk i përmbush kriteret bazë të stafit akademik lidhur me kërkimin. Megjithatë, në mbledhjen me stafin drejtues u sqarua se kjo shumë është posaçërisht vetëm për kërkimin nga studentët e doktoraturës në UBT **[BM10]**. Ndërkohë, për sa i përket kësaj sfide institucionale, në takimin e grupit të vlerësimit me Rektorin u tha se kërkimi shkencor nuk përfshihet në zërat buxhetorë të buxhetit vjetor të universitetit **[BM2]**. Një tjetër komponent i rëndësishëm është edhe angazhimi për të kryer punë për palë të treta në studime dhe vlerësime dhe zgjidhja e problemeve të ndryshme në komunitet **[A.2.63; Kapitulli II, Standardi I.1]**.

- 4.6 UBT-ja, bazuar në statutin institucional, inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor bazë dhe të aplikuar **[RVV, f. 78]**. Për këtë qëllim, është kryer integrim në Drejtorinë e Projekteve dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Shkencës dhe Promovimit Akademik **[A.1.28-A.1.29]**. Kjo lehtëson edhe kërkimin ndërinstitutional dhe shkëmbimin me universitetet partnere dhe qendrat e tjera kërkimore **[A.4.31]**. Një komponent i rëndësishëm i dinamikave kërkimore pasqyrohet përmes marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, veçanërisht ato me sektorin privat **[A.4.36-A.4.39 dhe A.4.53-A.4.54]**. Sipas dokumentacionit të disponueshëm, gjatë 5 viteve të fundit, një numër prej 13 studentësh gjithsej në UBT kanë marrë pjesë në projekte të ndryshme shkencore **[A.5.72]**. Grupi i vlerësimit i inkurajon fakultetet të rrisin përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore dhe të fuqizojnë sistemin për zbulimin e plagjiaturës përmes workshop-eve dhe seminareve për studentët **[Kapitulli II, Standardi I.2]**.
- 4.7 Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor është një tjetër synim i UBT-së në fushën e kërkimit **[RVV, f.79]**, pa lënë pas dore angazhimin e studentëve, veçanërisht atyre në ciklin e dytë të studimeve **[A.1.1, A.3.32, BM2, BM10]**. Ky segment, krahas kërkimit, është realizuar përmes konferencave të ndryshme dhe takimeve të tjera shkencore ndërkombëtare **[A.4.27]**, në të cilat ka pasur një pjesëmarrje gjithnjë e më të madhe të profesorëve. UBT-ja ka qenë një shembull i mirë i pjesëmarrjes në shumë projekte evropiane **[A.4.31]**. Kjo theksohet më tej nga publikimet në revistat shkencore me faktor ndikues. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare ka fuqizuar edhe kapacitetin infrastrukturor duke siguruar pajisje laboratorike, didaktike dhe kompjuterike. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se përfshirja aktive në partneritete ndërkombëtare është një **praktikë e mirë** e institucionit **[Kapitulli II, Standardi I.3]**.
- 4.8 Bazuar në analizën e dokumentacionit, UBT-ja ka përcaktuar fushat kryesore të kërkimit shkencor. Ato janë përcaktuar në përputhje me planin strategjik dhe strategjinë kombëtare të kërkimit **[A.1.1]**. Parametrat e prioritizimit janë bazuar në një sërë standardesh institucionale dhe mjedisesh kërkimore, që ndiqen nga një diskutim i gjerë në nivel departamenti **[A.4.1-A.4.3]**. Senati Akademik shqyrton dhe miraton propozimet për programet e doktoraturës, që priten të rihapen së shpejti. Departamentet përcaktojnë marrëdhënie të drejta ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit në planifikimin dhe financimin e veprimtarive kërkimore, që përditësohen çdo vit. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon se UBT-ja duhet të përgatisë një plan të qartë veprimi për zbatimin e strategjisë së kërkimit, duke përcaktuar synimet kyçe, treguesit e performancës dhe afatet kohore për veprimet **[Kapitulli II, Standardi I.4]**.
- 4.9 Institucioni zbaton prioritetet kërkimore bazuar në planin strategjik dhe programin e masave për zbatimin e strategjisë 2016-25 **[A.1.3-A.1.5]**. Senati Akademik miraton financimin e prioriteteve **[A.2.47-A.2.50]**, ndërsa njësitë bazë në analizën vjetore

përfshijnë realizimin e objektivave të të nxënit, duke trajtuar mangësitë dhe pengesat **[A.4.3]**. Zbatimi i prioriteteve bazohet në kuadrin akademik dhe infrastrukturën laboratorike, që janë përmirësuar ndjeshëm në vazhdimësi. Në fushën e botimeve shkencore, vërehet se disa fakultete kanë mbetur pas, kryesisht për shkak të mungesës së fondeve. Kështu, numri i botimeve me faktor ndikues në lidhje me stafin e FBM-së është 0.98 botime / profesor, ndërsa për FBU-në është vetëm 0.49. Grupi i vlerësimit sugjeron se fakultetet me numrin më të ulët të botimeve duhet të inkurajohen të rrisin numrin duke qenë një prioritet në mbështetjen financiare të kërkimit shkencor **[Kapitulli II, Standardi I.5]**.

- 4.10 Një komponent i rëndësishëm në fushën e kërkimit shkencor është edhe sigurimi i qëndrueshmërisë në fushën e kërkimit shkencor duke e vendosur këtë komponent në qendër të objektivave institucionale **[RVV, f. 82]**. Kjo është bërë e mundur përmes thellimit të integritit të kërkimit në mësimdhënie duke angazhuar studentët në universitet dhe ata të diplomuar në projekte kërkimore; përmes fuqizimit të lidhjeve ekzistuese me partnerët ndërkombëtarë dhe vendas; rritjes së mobilitetit, rekrutimit të punonjësve të rinj dhe ngritjes së kapacitetit laboratorik **[A.2.10; Kapitulli II, Standardi I.6]**.
